

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MATURA SHTETËRORE PROFESIONALE

### MODEL TESTI

#### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI"

Prill 2024

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsytim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

#### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Kërkesa	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Kërkesa	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Kërkesa	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Kërkesa	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Në motorin me djegie të brendshme (MDB): **1 pikë**  
A) energjia termike shndërrohet në energji kimike.  
B) energjia potenciale shndërrohet në energji termike.  
C) energjia kimike shndërrohet në energji potenciale.  
D) energjia termike shndërrohet në energji mekanike.
2. Në motorin katërkohësh me gjashtë pistona, për një cikël pune, numri i lëvizjeve të pistonit midis dy pikave të vdekura është: **1 pikë**  
A) dy herë.  
B) katër herë.  
C) gjashtë herë.  
D) tetë herë.
3. Në motor, fashot elastike: **1 pikë**  
A) vendosen në trupin e cilindrit.  
B) lejojnë që gazrat të depërtojnë në karter.  
C) lejojnë vajin të kalojë në hapësirën për djegie.  
D) pengojnë depërtimin e gazeve në hapësirën piston-cilindër.
4. Në motorët me dy kohë, gjatë kohës së punës: **1 pikë**  
A) kryhet vetëm zbrazja.  
B) kryhet njëkohësisht ngjeshja, fryrja dhe zbrazja.  
C) kryhet njëkohësisht vetëm zbrazja dhe ngjeshja.  
D) kryhet vetëm thithja.
5. Bobina induktive e sistemit të ndezjes: **1 pikë**  
A) prodhon një rrymë me intensitet të lartë.  
B) prodhon një rrymë me tension të lartë.  
C) përbëhet nga tre pësjtjella me 250-350 spirale teli.  
D) pësjtjella primare përbëhet nga 15000-20000 spirale teli.
6. Karakteristika kryesore e benzinës, *numri i oktanit* ka vlera nga: **1 pikë**  
A) 30 - 50 oktan  
B) 50 - 70 oktan  
C) 80 - 100 oktan  
D) 100 - 120 oktan
7. Diagnostikimi elektronik i sistemeve të automjetit: **1 pikë**  
A) përcakton gjendjen teknike të sistemit.  
B) realizohet duke çmontuar sistemin.  
C) kryhet vetëm kur ka parregullsi të sistemit.  
D) kontrollon vetëm funksionimin e motorit.
8. Sonda "lambda": **1 pikë**  
A) mat përmbajtjen e oksigjenit në kolektorin e thithjes.  
B) mat përmbajtjen e oksigjenit në hyrje të turbo-kompresorit.  
C) mat përmbajtjen e oksigjenit në gazrat e djegura.  
D) mat përmbajtjen e oksigjenit në dhomën e djegies.
9. Kur masim shkallën e komprimimit në cilindër konstatohet gjendja teknike e: **1 pikë**  
A) injektorit të lëndës djegëse.  
B) kandeletës ngrohëse.  
C) kandeles së ndezjes.  
D) fashove elastike.

- 10. Sistemi i frenimit ABS:** **1 pikë**  
A) është sistem shtesë i sistemit të frenimit hidraulik.  
B) bën të mundur bllokimin e rrotave gjatë frenimit.  
C) vepron vetëm mbi rrotat aktive të automjetit.  
D) aktivizohet në mënyrë automatike, pa vepruar mbi pedal.
- 11. Parametri teknik që përcakton nëse disku i frenit duhet zëvendësuar është:** **1 pikë**  
A) diametri i jashtëm i diskut.  
B) ngjyra e sipërfaqes së jashtme të diskut.  
C) trashësia (spesori) e diskut.  
D) temperatura e diskut.
- 12. Kutia e ndërrimit të shpejtësisë automatike nxehet për shkak të:** **1 pikë**  
A) bllokimit të levës së komandimit të kutisë.  
B) përdorimit të shpeshtë të pedales së friksonit.  
C) nivelit të ulët të sasisë së lubrifikuesit.  
D) ndalimit të mjetit me motor të ndezur në pozicionin "N".
- 13. Në sistemin e ndezjes elektronike të integruar, kur motori është me katër cilindra, numri i fijeve të tensionit të lartë që dalin nga bobina induktive janë:** **1 pikë**  
A) 0  
B) 1  
C) 2  
D) 4
- 14. Njësia matëse për vlerat e Konvergjencës së rrotave është:** **1 pikë**  
A) gradë  
B) minuta  
C) milimetra  
D) centimetra
- 15. Në impiantet e ajrit të kondicionuar avulluesi është një shkëmbyes nxehtësie i llojit:** **1 pikë**  
A) ajër - gas  
B) ajër - ujë  
C) ajër - vaj mineral  
D) ajër - vaj sintetik
- 16. Në sistemin e ftohjes:** **1 pikë**  
A) intensiteti i ftohjes duhet të varet nga shpejtësia e lëvizjes së mjetit.  
B) intensiteti i ftohjes duhet të varet nga ngarkesa e motorit.  
C) ventilatori punon gjithnjë pa ndërprerje.  
D) në temperatura të ulëta, ka numër rrotullimesh më të madh.
- 17. Konvertori katalitik (katalizatori):** **1 pikë**  
A) vendoset para kolektorit të shkarkimit.  
B) bazohet në procese kimike të shpërbërjes.  
C) funksionon më mirë në temperatura të ulta.  
D) rrit presionin e gazrave të djegies.
- 18. Punimet e mirëmbajtjes parandaluese në mjetin e transportit:** **1 pikë**  
A) kryhen të planifikuara nga prodhuesi.  
B) kryhen vetëm në autoservise të autorizuara.  
C) kryhen pas riparimit.  
D) kryhen pasi kanë ndodhur defektet.

- 19.** Automjeti vibron gjatë ecjes me shpejtësi të ulët kur: **1 pikë**
- A) gominat e amortizatorëve janë çarë.  
 B) goma ka presioni mbi vlerën normale.  
 C) goma është e deformuar.  
 D) gomat janë të shfryra.


- 20.** Nëse bllokohet kanali i vajit në trupin e bjellës, atëherë ndodh: **1 pikë**
- A) konsumimi i kushinetave të bangove.  
 B) konsumimi i shpejtuar i bokullës së spinotit.  
 C) bllokimi i kushinetave të bangove.  
 D) nxehja e kushinetave të bangove.

- 21.** Listoni 4 detyrat e guarnicionit (hermetizuesit) të kokës së motorit: **4 pikë**
1. \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_  
 3. \_\_\_\_\_  
 4. \_\_\_\_\_

- 22.** Tregoni 2 nga dallimet kryesore ky bazohet klasifikimi i MDB. **2 pikë**
1. \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_

- 23.** Plotësoni vendet bosh në fjalinë e mëposhtme. **2 pikë**
- Mekanizmi bjellë-manivelë, shërben për transmetimin e forcës së gazeve te boshti motorik dhe kthimin e lëvizjes vajtje-ardhje të \_\_\_\_\_ në lëvizje rrotulluese të \_\_\_\_\_.

- 24.** Në figurën e mëposhtme të sistemit të drejtimit, emërtoni elementët numër 1 dhe me numër 2: **2 pikë**
1. \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_



- 25.** Vendosni e vërtetë (V) ose e gabuar (G) në pohimet e mëposhtme. **3 pikë**
- a) Nëse e heqim termostatin nga foleja e tij, motori nxehet shumë ngadalë. \_\_\_\_\_  
 b) Ndërrimi i filtrit të vajit të motorit është punim riparimi. \_\_\_\_\_  
 c) Për të përcaktuar kandelen që nuk funksionon stakohen me radhë kabllot e baterisë. \_\_\_\_\_

26. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë.

4 pikë

- |  |   |   |
|--|---|---|
| a) Forma e boshtit motorik ndikon te rradha e ndezjes së përzierjes djegëse.   | V | G |
| b) Vlera termike e kandelës është karakteristika e cila tregon rezistencën ndaj dukurisë së vetëndezjes.   | V | G |
| c) Informacioni i sensorit MAP digital (i presionit absolut) përdoret nga njësia kontrolluese (ECU) për matjen e presionit në kolektorin e shkarkimit. | V | G |
| d) Tensioni i baterisë me takimin e çelësit të kuadrit, është më i madh se 12.35 Volt  | V | G |

27. Në sistemin EOBD:


2 pikë

- |   |   |   |
|---|---|---|
| a) Funkcionimi i pompës të ajrit shtesë kontrollohet nga sinjali i gjeneruar i Sondës Lambda.           | V | G |
| b) Nëse defekti nuk përsëritet në ndezjen pasardhëse, kodi i difektit fshihet automatikisht nga memorja | V | G |

28. Në figurën e skemës së mëposhtme emërtoni elementët:

3 pikë

- a) Elementin "1" \_\_\_\_\_
- b) Elementi "2" \_\_\_\_\_
- c) Elementi "3" \_\_\_\_\_



29. Rrethoni PO ose JO në pohimet e mësipërme, që i referohen skemës së mësipërme:

4 pikë

- |   |    |    |
|---|----|----|
| 1. Elementi "4" nuk lejon kalimin e lëndës djegëse kur është e papastër.  | PO | JO |
| 2. Elementi "5" është pompë me presion të ulët.                           | PO | JO |
| 3. Elementi "6" funksionon kur temperatura e lëndës djegëse është e ulët. | PO | JO |
| 4. Elementi "7" mat temperaturën e lëndës djegëse.                        | PO | JO |

30. Listoni tre nga efektet negative që sjell mungesa e lubrifikimit në kutinë e shpejtësisë:

3 pikë

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

31. Në figurën e skemës së mëposhtme emërtoni elementët:

5 pikë


Elementi "2" \_\_\_\_\_

Elementi "3" \_\_\_\_\_

Elementi "4" \_\_\_\_\_

Elementi "5" \_\_\_\_\_

Elementi "7" \_\_\_\_\_



32. Në skemën e mësipërme tregoni detyrat e elementëve 1 dhe 6:

2 pikë

Elementi "1" \_\_\_\_\_

Elementi "6" \_\_\_\_\_

33. Në secilin nga pohimet e mëposhtme, rrethoni përgjigjen e saktë:

4 pikë

- |   |    |    |
|---|----|----|
| a) Sistemi i rregullimit të ndriçimit të përparmë përdor ndriçues dinamikë.   | PO | JO |
| b) Siguria pasive krijohet nga tërësia e karakteristikave teknike, që ndihmojnë aktivisht për sigurinë e kontrollit të mjetit në lëvizje. | PO | JO |
| c) Oshiloskopi përdoret për matjen e madhësive jo elektrike pa i konvertuar në sinjal elektrik.   | PO | JO |
| d) Filtri i grimcave (pm) DPF i vendosur në makinat me naftë ruan brenda trupit të tij vetëm grimcat pm.                                  | PO | JO |



